

2 Mbledhja e delegatëve të SGB/USS
Kërkohet fuqizimi i shërbimeve publike

3 BE-ja dhe përparimi shoqëror
Fëmijët tanë do të duhej ta kenë më mirë se sa ne

4 Kosovë: Siguria dhe Shëndeti në Punë: Arsyet pse duhet ndryshuar dhe mbikqyrur ky ligj

Nr. 4 | qershor 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

KKP e re në Industrinë e MEM për vitin 2018–2023 Sukses falë partneritetit të fuqizuar social



Pamje nga demonstratat e punëtorëve të industrisë për mbrojtjen dhe avancimit e të drejtave të tyre

Në industrinë e makinerisë, elektrike dhe atë të metalit (MEM) është arritur një Kontratë e re Kolektive e Punës (KKP). Për mes kësaj është mundësuar pengimi i përkeqësimeve për mbi 100 000 punëmarrës të kësaj degje, si dhe të fuqizohen udhëzime përmirësuese. Pas aprovimit të organeve të degës, KKP e re hynë në fuqi me 1 qershor 2018 dhe vlen deri me 30 qershor 2023.

Zbatimi i vijës këmbëngulëse të Unia

Edhe bisedimet e vitit 2013 për KKP e industrisë MEM kanë qenë të përcjella me konflikte të ashpra rreth futjes së pagës minimale për herë të parë. Përcaktimi i saj me kontratë ka qenë një depërtim i rëndësishëm. Sindikata Unia edhe në bisedimet e reja zhvilloi ballafaqimin e atëhershëm të partneritetit social edhe më tej. Dhe ishte e suksesshme.

U zbraps rritja e orarit të punës

Para bisedimeve kërkesa kryesore e shoqatës së punëdhënësve «Swissmem» ishte rritja e orarit javor të punës nga 40 në 42 orë. Edhe përkundër rrethanave aktuale të kërkesave këmbëngulëse për heqjen e kufizimeve dhe zgjerimin e kohës së punës, Unia ia arriti që të zbrapsë zgjerimin e orarit të punës.

Përmirësimet e arritura

■ Baraspeshimi automatik i shtrenjtimit dhe kontrolli i pagave minimale

Ruajtja e fuqisë blerëse ka vite që është njëra ndër kërkesat kryesore të punëmarrësve. Në KKP më në fund është përkufizuar parimi, sipas të cilit pagat minimale u përshtaten automatikisht zhvillimeve shtrenjtuese. Në rast të shtrenjtimit negativ, pagat nuk do të ulen. Kjo mundëson zhvillimin pozitiv të pagave në degën e industrisë MEM.

Për të garantuar zbatimin e marrëveshjes, do të kontrollohet respektimi i pagave minimale në KKP të ndërmarrjeve poseduese nga ana e auditorëve.

■ Kërkesat e grave, pajtueshmëria e punës dhe e familjes

Punëdhënësit janë obliguar, të përmirësojnë ngritjen në pozita të grave. Për të cytur rikthimit të grave në jetën profesionale, duhet të ndërmerren reduktime të kohëpaskohshme të orarit të punës me rastin e obligimeve familja-

re, apo veprime për të mundësuar mbështetjen e organizimit të përkujdesjes jashtë familjare të fëmijëve. Rishtas, pos tjerash mundësohet ndarja e përqindjeve të punësimit të pjesshëm në më shumë ditë (p.sh. 60% në 4 ditë, në vend se në 3 ditë)

Ofensiva arsimore për të rritur përmes «MEM-Passarelle 4.0» së re

Në një kohë të digjitalizimit të shpejtë në rritje punëmarrësit gjenden para sfidave të reja. Një risi e KKP-së është «MEM-Passarelle 4.0». Ajo bazohet në konceptin e sindikatës Unia, i cili mbështet «Aftësimin profesional për të rritur». Fjala është për një instrument konkret për të mbështetur aftësim-trajnimin e punëtorëve dhe për tu hapur atyre perspektiva të reja personale dhe profesionale.

Promovimi dhe mbrojtja e punëtorëve të moshuar

Punëtorët e moshuar shpesh janë pozitë të pavoritshme. An-

daj, mbrojtja e tyre ishte një ndër preokupimet kryesore. Neni për mbrojtje të shkarkimit nga puna për punëtorë të moshuar i obligon ndërmarrjet, që çdo shkarkim nga puna të punonjësve të shtyrë në moshë ta shqyrtojnë individualisht dhe të kërkojnë zgjidhje alternative. Pos tjerash është kontraktuar zgjatja e afatit të shkarkimit nga puna për një muaj për punëmarrësit nga moshja 55 vjet dhe 10 vite përvojë.

Neni për rast krizash

Tek neni për raste krizash, i cili autorizon punëdhënësin – në rast pajtimi paraprak të punëmarrësit – të rrisë orarin e punës në rrethanë të definuar qartë, është arritur që të reduktohet nga 30 muaj në 24 muaj. Punëdhënësit duhet që sindikatave tua komunikojnë me shkrim të dhënat mbi motivet dhe zbatimin. Ndërsa përfaqësuesit e punëmarrësve kanë mundësinë që në çdo kohë të ftojnë sindikatën në tryezën e bisedimeve.

Marília Mendes

Editorial



Mjeti më i mirë integrues është shërbimi publik

Shërbimet publike (Service public) nuk bënë dallime mes të riut dhe plakut, grave dhe burrave, apo vendaseve dhe ardhacakëve. Uji i pastër i pijes, largimi i shpejtë i mbeturinave dhe furnizimi elektrik nuk janë më të mirë për ata, që fitojnë më shumë apo që posedojnë pasaportë zvicerane. Bileta e trenit për në Bernë është njësoj shtrenjtë për të gjithë, në të vërtetë e shtrenjtë. Qasje në shkollimin publik kanë të gjithë dhe edhe sigurimi elementar shëndetësor ndryshon në bazë të vendbanimit, por jo shkak i dallimeve në kombësi. Përkujdesja e mirë mjekësore në spital, është e rëndësishme në masë të njëjtë për të gjithë.

Parë kështu, shërbimi i mirë dhe i gjerë publik është mjeti më i mirë integrues. Cilësia e mirë e shkollimit, edhe atij profesional, infrastrukturave dhe rrjetit i sigurimeve tona shoqërore janë themelet nismëtare për një përditshmëri bashkëjetuese në Zvicër. Falë shërbimeve publike ne nuk kemi hendeqe të mëdha sociale si fjala bien në SHBA, ku shërbimet publikë posedohen vetëm tejet të kufizuara. Nëse reduktohen shërbimet publike, atëherë të prekur janë njerëzit me të ardhura më të vogla, ndryshe dhe më keqas se ata me të ardhura më të mira. Pasi edhe tek ne kemi shembuj të panumërt, ku shërbimet publikë dëmtohen në favor të ofertave private: mësimi muzikor në shkollë i nënshtruar diktatit kursimtar dhe zhvillohet më tej si ofertë private, për të cilën njerëzit duhet të paguajnë. Përkujdesja themelore në spital, në disa vendbanime është e kufizuar, për të mos folur për përkujdesjen psikiatrike, e cila dështon shkak i mungesës së të kuptuarit mes pacientëve dhe profesionistëve. Në shkollë unë fëmijës tim mund t'ia krijoj një përparësi përmes mësimi plotësues, mundësi që jo të gjithë mund ta shfrytëzojnë. Ndërsa për në Bernë, udhëtimi në klasën e parë është shumë më komodë. Megjithatë edhe sot e kësaj dite, shërbimi publik mbetet garancia më e mirë e shanseve të barabarta në Zvicër. E parandalon përjashtimin social! Andaj është në interes të të gjithë neve, që të luftojmë për shërbime publike të forta!

Dore Heim, sekretare qendrore në SGB/USS

News

Qyteti-Bazelit: Referendum kundër orareve të gjata të shitoreve

Sindikata Unia kundërshton vendimin e parlamentit të Kantonit Qyteti-Bazelit për zgjatjen e orarit të punës së shitoreve. Caktimi i orarit të punëve në mbrëmje në kushtet e tanishme të punës për personelin shitës nuk është i arsyeshëm. Më 5 qershor 2018 këshilli i Kantonit Qyteti-Bazelit ka vendosur zgjatjen e orarit të punës për dy orë të shtunave dhe në ditët para festave. Unia kundërshton përmes referendumit zgjatjen gjithëherë e më shumë të orarit të punës.

SGB/USS dhe Travail.Suisse kërkojnë përmirësim tek shtylla e dytë e sigurimeve shoqërore

Shtylla e dytë e pensioneve (trusteve pensionale) ka një problem performance. Pensionet mesatare të pensioneve të reja nga shtylla e dytë ka disa vite që ulen, edhe pse pagat dhe ekonomia po rriten. Dhe edhe pse në pesë vitet e fundit renditi mesatar i trusteve pensionale ka shënuar rritje prej 5%. Të dyja sindikatat dhe shoqatat çati të punëmarrësve SGB/USS dhe Travail.Suisse kërkojnë, që të zbatohet mandati kushtetues: pensionet e AHV/AVS dhe ato të shtyllës së dytë duhet që të mundësojnë «Vazhdimi i jetës normale në një mënyrë të përshtatshme» – edhe për njerëzit me të ardhura të ulëta dhe mesatare.

Progredir– arsimimi profesional për migrantët në gastronomi në kantonin Bernë

Nëse ti ke vite që punon në gastronomi dhe dëshiron që të pasurosh njohurit tua gjuhësore e profesionale, apo të arrish përfundimin e shkollimit të certifikuar me diplomë të njohur si kamerier/e apo kuzhinier/e, atëherë Progredir është edhe për Ty! Arsimimi fillon pas pushimeve verore 2018. Paraprakisht me Ty do të zhvillohet një bisedë dhe një pozicionim. Të ftojme të na kontaktosh! Unia Bern, Michael Bolettieri, T+41 31 385 22 22, bern@unia.ch ECAP Bern, Mara Zala, T+41 381 81 33, infobe@ecap.ch, www.progredir.ch

Të punësuarit e shitoreve të pikave të karburanteve në Tiçino kërkojnë pagë minimale sikur në gjithë Zvicrën

Tmë 5 qershor një delegacion i të punësuarve në shitoret e pikave të karburanteve nga regjioni i Tiçinos kanë takuar parlamentarët nacional që janë të zgjedhur nga ky regjion. Ata luftojnë që paga minimale, sikur është përcaktuar me KKP për shitoret e pikave karburanteve në të gjithë Zvicrën, të vlejë edhe për regjionin e Tiçinos. Në nëntor të vitit 2015 shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat kanë nënshkruar një Kontratë Kolektive të Punës për shitoret e pikave të karburanteve. Qeveria federale në dhjetor të vitit 2017 e ka shpall KKP në fjalë të vlefshme për të gjithë Zvicrën. Një përjashtim paraqet paga minimale për kantonin e Tiçinos: Të punësuarit e Tiçinos, të cilët janë të prekur veçanërisht nga dumpingu në paga, mjerisht nuk mund të shijojnë pagën minimale.



Dega elektriciste Protesta i shtynë punëdhënësit të lëvizin

Më shumë se 400 elektricistë/e nga e tërë Zvicra kanë protestuar me 19 maj në Cyrih. Ky mobilizim i rrallë për këtë degë ka qar në suksesin e parë: Punëdhënësit kanë vendosur që të tërheqin planin e tyre për 44 orë punë në javë.

Pjesëmarrësit në manifestim kanë udhëtuar nga të katër anët e Zvicrës, për tu tubuar në stacionin kryesor të trenit dhe nga aty për të marshuar deri tek selia zvicerane e Shoqatës së firmave elektro-instaluese (VSEI). Atje ata dorëzuan një peticion mit 4474 nënshkrime. Përmes tij ata kërkojnë përmirësim substancial të kushteve të punës dhe të pagave në kuadër të ripërtëritjes e sivjetme të Kontratës Kolektive të Punës (KKP).

Mobilizimi i fuqishëm detyron punëdhënësit që të bëjnë një

tërheqje

Ndikimet e para pozitive të mobilizimit janë tanimë të prekshme: Përfaqësuesit e VSEI janë tërhequr nga synimi ki tyre për të rritur orarin e punës nga 40 në 44 orë pune në javë. «Kjo fitore e parë inkurajuese tregon se mobilizimi ia vlen. Tani ne duam që të angazhohemi për shqetësimet e preokupimet tona tjera. Ato janë të pashmangshme, nëse duam të sigurojmë ardhmërinë për njerëzit e profesionit të degës elektriciste në Zvicër» është shprehur Aldo Ferrari, nënkryetar i Unia dhe drejtues i sektorit artizanal.

Duhet përballur me sfidat e digjitalizimit

Dega elektriciste gjendet në ballë të frontit të digjitalizimit në zhvillim e sipër. Shumë sfida duhet menaxhuar dhe VSEI duhet të ndërmerre masa të duhura. Nuk është e pranueshme që të rinjtë t'ia kthejnë në mënyrë massive kurrizin këtij profesioni. Andaj, sindikatat Unia dhe Syna kërkojnë pos tjerash një përmirësim të përgjithshëm të pagave, ditë shtesë për trajnim të mëtejme dhe pensionim të parakohshëm me 62 vjet.

Osman Osmani



Aksioni i elektricistëve për kushte më të mira pune

Mbledhja e delegatëve të SGB/USS e 25.05.2018

Kërkohet fuqizimi i shërbimeve publike

Edhe pse votuesit në Zvicër disa herë radhazi janë deklaruar në të mirë të shërbimeve publike, nga fundamentalistët e tregut 'Servile public' vihet në pikëpyetje gjithnjë e me shpesh, apo përmes programeve kursyese venë nën presion sektorin publik. Delegatët e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës kanë diskutuar këto sulme dhe sfida të reja dhe kanë aprovuar një rezolutë.

Kështu, politika e taksave duhet të përafrohen me nevojat financiare të shërbimit publik. Në vend të projekteve të reduktimit të taksave shkaktëruese në kantone dhe komuna, nevojitet taksim minimal, që pengon konkurrencën tatimore në mes të kantoneve. Masat kursyese tek personeli i sektorit publik, gjegjësisht tek personeli në institucionet federale si deh tek ata kantonal e komunal refuzohen, ashtu sikur edhe eksperimentet konkurruese të pakuptimta dhe logjika e tregut, e cila shkatërron shërbimet publike: nuk nevojitet politikë e transportit që çon në dumping çmime dhe dumpingun e pagave, as e ndalimit të kabotazhit, apo liberalizim të transportit ndërkombehtar dhe kombëtar të udhëtarëve!

Digjitalizimi social

Digjitalizimi është një shanse për shërbimin publik, nëse ndërmarrjet e shkollojnë dhe trajnojnë më tej personelin. Nevojitet një zgjerim e jo reduktim të transformimit digjital të shërbimeve publike. Marrë parasysh presionin karshi pagave në sektorin e komunikacionit, tek posta dhe shërbimeve postare si dhe në lëmin sociale dhe përqësimin akut të kushteve të

punës veçanërisht në degën e mediave dhe në lëmin shëndetësore, delegatët kërkuar që të punësuarit në shërbime publike duhet tu nënshtrohen Kontratave obliguese Kolektive të Punës. Në sektorët publik si Hekurdhat Telekomunikacioni dhe Postën, duhet që pagat e kuadrove të kufizohen në 500 000 franga në vit.

Kundër planifikimit të shkurtimeve tatimore në fitim

Më tej delegatët përmes një rezolute vendosën që ta luftojnë parashtrësën tatimore nr. 17 të kantoneve të planifikuar për shkurtimin e tatimit në fitim. Kantonet duan të ngulin këmbë në zbritjen e tatimit problematik dhe të tepruar në fitim, edhe pse shumica e popullatës votuese nga frika e humbjeve tatimore dhe pagesave shtesë kanë shkurtuar reformën tatimore III të korporatave. Vendimin e komisionit ekonomik të këshillit të kantoneve, të zgjerimit në parashtrësën tatimore për fuqizimin e financimit të AHV/AVS, delegatët e vlerësuan pozitivisht. Mirëpo, SGB/ USS do të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të parashtrësës tatimore nr. 17, tek pasi të merren vendimet përfundimtare.

Kundër diskriminimit në paga

Delegatët e SGB/USS fuqizuan dëshirën për përparime në çështjen e barazisë në paga. Për këtë arsye ata bashkë me një aleancë të gjerë të organizatave të grave ftuan për një manifestim nacional për datën 22 shtator në Bernë, për barazi në paga dhe kundër diskriminimit. Duhet rritur presioni karshi parlamentit që përmes revidimit të ligjit për barazi më në fund të ankorohet detyrimi kontrollues dhe mundësia sanksionuese.

Solidaritet me punëtorët e ndërtimtarisë

Pos tjerash delegatët përmes një rezolute tjetër u siguruan punëtorët e ndërtimtarisë solidaritet të plotë për të mbrojtur pensionimin me 60 vjet në ndërtimtari. Nuk është e korrekte që punëtorët e ndërtimtarisë të punojnë më gjatë, e të fitojnë më pak dhe që t'ju duhet të shkojnë në pension me pensione më të vogla. Delegatët e SGB/USS kërkuar nga Shoqata e punëdhënësve zviceran që të heqin dorë nga qëndrimi i tyre refuzues dhe përfundimisht të negociojnë.

Osman Osmani

14 qershori: Ditët e aksionit për barazi në paga Gratë akuzojnë senatin dhe punëdhënësit

Me 14 qershor, me rastin e jubileut të grevës së grave, janë zhvilluar aksione në të gjithë Zvicrën. Në disa regjione gratë lexuan akuzat e tyre pasi gjithmonë e më shumë gra janë të zemëruara.

Kështu në Bazel një grua theksoi: «Unë akuzoi këshillin e dhomës së kantoneve, pasi ai me taktikën zvarritëse dhe të dobësimit, me qëllim dhe vetëdije po pengon barazinë në paga». Mirëpo me këtë rast është paditur edhe punëdhënësi: «Unë padisë punëdhënësin për 7 miliardë frangat, të cilat ne grave na mungojnë në kuletë.», tha një grua me mikrofon në Bernë. Mirëpo edhe aksione, si fjala bie në Cyrih, punëdhënësit thirren në përgjegjësi.

Vor der Economie Suisse hat man Pappfiguren in Paaren von Mann und Frau aufgestellt, daneben sind die unterschiedlichen Löhne angegeben. Denn für uns ist klar Schuld daran, dass die Lohnungleichheit noch immer nicht umgesetzt wurde sind die Arbeitgeber. Sie weigerten sich nicht nur mehrheitlich am freiwilligen Lohngleichheitsdialog teilzunehmen, sondern sind, mit ihrem Lobbying, auch mitverantwortlich dafür, dass die Vorlage nochmals an die Kommission zurückgeschickt wurde und dann im Ständerat weiter verwässert wurde.

Arbeitgeber begehen Vertragsbruch

Für uns ist klar, mit der nicht Umsetzung der Lohngleichheit begehen sie einen Verfassungsbruch. Diese Wut wurde in einigen Regionen auch mit dem Fussball kombiniert, da die WM am selben Tag angepfiffen wurde. So verteilten in Bern Freiwillige kleine rote Karten gegen den Verfassungsbruch und in Genf ging man in der Fanzone Flyer verteilen. Denn wie dem Fussballschiri geht es uns bei der Lohngleichheit lediglich um Fairplay zwischen Männern und Frauen. Auch in den Betrieben haben wir das vermittelt. Dort haben wir das Lohn Quiz verteilt und mit den Menschen über, die Ungleichheit in den Löhnen gesprochen. Mit diesen kämpferischen Aktion würdigten wir unsere Vorkämpferinnen und den Frauenstreik, der vor 27 Jahre das Land still stehen liess. Dank den zahlreich anwesenden Freiwilligen konnten wir, sehr viele Menschen erreichen und Lust machen auf die grosse Lohngleichheitsdemo am 22. September in Bern.

Virginia Koepfli



Pamje nga një manifestim i sivilizuar në Bernë për barazinë e pagave për gra

Studimi mbi strukturën e pagave 2016 Pabarazi në paga dhe ulje pagash në ndërtimtari

Pagat mesatare mes vitit 2014 dhe 2016 janë rritur 1.2%. Megjithatë përshtatja e pagave të grave është duke shkuar shumë ngadalë. Dhe: Pagat në degën e ndërtimtarisë edhe përkundër lulëzimit të punëve ndërtimore janë ulur.

Sindikata Unia percepton rritjen e gjithmbarshme të pagave për rreth 1.2% si pozitive – presioni sindikalist ka arritur të mënjanohet gjatë vitit të mëdha në paga. Rritja e pagave për sektorë: 1.4% në degën e industrisë, 0.7% në sektorin e shërbimeve, 1.2% në lëmin shëndetësor, 1.1% në industrinë kimike, 1.5% në industrinë farmaceutike dhe 0.8% në tregtim të vogël. Një ngecje pagash ka pasur në industrinë ushqimore dhe atë të pijeve, tek makineria ndërtuese dhe tek gastronomia.

Ritëm kërmilli me rritjen e pagave të grave

Edhe përkundër këtij zhvillimi pozitiv dallimi në paga me grave dhe burrave u reduktua vetëm me një përqindje prej 0.5%. Kjo është shumë pak. Corinne Schärer, anëtare e drejtorisë qendrore në Unia e vlerëson këtë si të papranueshme dhe kërkon «kontrolle sistematike dhe të detyrueshme si deh dënime të larta për ndërmarrjet, të cilat nuk respektojnë ligjin.»

Politika të gabueshme pagash në industrinë e ndërtimit

Ekonomia në sektorin e ndërtimit është e mirë, në sajë të punëtorëve të ndërtimtarisë që punojnë ditë e përditë pamarrë parasysh motin. Për ta është rritur vetëm presioni dhe ritmi i punës. Pagat janë zbritur varësisht nga punët ndërtimore, tek nderimi i lartë për 0.9% dhe tek ai i thellë për 1.4%. Unia kërkon një rritje të përgjithshme 150. – franga për të gjithë punëtorët e ndërtimit. Më shumë se 50% e të punësuarve marrin pagë më pak se 5000. – franga Pagat mesatare prej 6502 frangave mbivlerëson pagat efektive. Mbi 50% e të gjithë të punësuarve në Zvicër marrin në muaj më pak se 5000 franga, tek gratë kemi të bëjmë me 70%. Andaj, Unia kërkon më shumë KKP dhe paga korrekte për të punësuarit.

Marilia Mendes



Shkrime të hauzuara nga: Riegers Europa



Përparimi shoqëror: një çështje kjo politike

Prindërit dhe gjyshërit tanë në vite e 1950ta dhe të 1980ta mund të thoshin: «Fëmijët tanë do ta kenë më mirë se sa ne.» Evropa kishte plot besim në përparimin shoqëror. Sot ky besim duket se është zhdukur. Njerëzit janë të tronditur nga krizat e përsëritura ekonomike dhe kanë frikë nga rënia sociale.

Finlandezët janë të kënaqur

Sikur tregon anketa evropiane mbi kualitetin jetësorë, progresi (përparimi) dhe regresi (prapambetja) varen nga politika. Njerëzit nga Finlanda e shohin situatën e tyre shumë pozitive. Ata, sa i përket ardhmërisë së fëmijëve të tyre, janë edhe më optimistë. Të kundërtën e mendojnë në Greqi: Njerëzit atje e vlerësojnë situatën e tyre si më të vështirën nga të gjitha vendet e BE-së. Ndërsa situatën e fëmijëve të tyre, ata e shohin edhe më të zymtë. Dallimi mes Finlandës dhe Greqisë? Finlanda ka një shtet të zhvilluar të mirëqenies. Greqia, nga ana tjetër, është detyruar nga Trojka e BE-ja që të ndërmarrë hapa brutale sa i përket mirëqenies.

A do ta kenë ndonjëherë fëmijët më mirë?

Jo edhe aq të keqe e vlerësojnë situatën e tyre njerëzit në Francë dhe në Gjermani. Sa i përket gjeneratës së ardhshme, pas viteve të politikës neoliberalë, ata janë më pesimist. Tërësisht ndryshe nga njerëzit në Bullgari. Poloni e vendet baltike. Këto vende vijjnë «nga poshtë» dhe përdërisa prindërit kursejnë gjithçka që është e mundur, gjasat janë të mëdha, që fëmijët e tyre të kenë më shumë mundësi.

Politika kursyese nuk është model shembull

Përparimi shoqëror ka nevojë për politikë të drejtë. Politikën kursyese e BE-së me nuk ka qenë shembull i mirë. U mbetet forcave përparimtare në Evropë, përfshirë edhe sindikatat, për të qar më tej një projekt të dobishëm shoqëror gjithëpërfshirës. Kështu përsëri më shumë njerëz do të mund të thonë: «Fëmijët tanë do ta kenë ndonjëherë më mirë.»

work, 13 prill 2018

Reformat e BE-së: Ato ekzistuan!

Pas Krisës së vitit 2008 politikën kursyese të BE-së kishte ndikime antishoqërore tek njerëzit. Çrregullimi i tregut të punës krijoi pasiguri dhe vende punë ke kushte të këqija. Dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë shfuqizoi shumë rregullore që duhej të parandalonin dumpingun në paga.

Brukseli çuditet

Më së keqi, kjo politikë, goditi Greqinë dhe vendet të tjera të jugut. Mirëpo edhe Gjermaninë: komunat u varfëruan, infrastruktura u stërkeq, dhe u krijua sektori më i madh i pagave të ulëta në Evropë. Përgjegjësit e kësaj situatë: ish-kryetari i BE-së José Manuel Barroso, ish ministri gjerman i thesarit Wolfgang Schäuble dhe Trojka (Komisioni evropian i bankës qendrore si deh fondi monetar ndërkombëtar). Dhe elita politike në Bruksel çuditej, që BE-ja mbeti thuajse pa përkrahje.

Kthesa shoqërore në drejtim të duhur

Kryetari i zgjedhur me 2015 i Komisionit të BE-së, Jean Claude Juncker bëri premtime sociale. Tani me «themelet e të drejtave sociale» duken përsëri përparimet në BE. Direktivat përkitazi me punëmarrësit e dërguar do të shtrëngohen me qëllim të frenimit të dumpingut në paga. BE-ja tani po krijon një agjenci punësimi për të zbatuar mbrojtjen e punonjësve përtej kufijve. Rishitas duhet që të regjistrohen vlerat themelore të secilës punësim në një kontratë pune me shkrim. Dhe BE po punon për të përmirësuar kushtet për punëtorët me përgjegjësi familjare. E gjithë kjo nuk është ende një kthesë e madhe, por BE po bën një kthesë shoqërore në drejtimin e duhur. Në Zvicër, punëtorët mund të jenë të lumtur vetëm për këtë. Këtu vazhdon të fryj fryma e ashpër e shkurtimeve sociale dhe çrregullimit.

work, 29. März 2018

Andreas Rieger, ish bashkë-kryetar i sindikatës Unia. Ai është aktiv edhe më tej në lëvizjen sindikaliste evropiane.

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Afati i shkarkimit nga puna: a duhet ta kompensojë me punë qëndrimin në spital?

Unë kam dhënë dorëheqje nga kontrata ime e punës për në fund të korrikut. Kah mes i qershorit unë duhet të operoj gjurin, andaj nuk do të mund të punoj për afërsisht dy javë. Punëdhënësin tim e kam informuar me kohë për operacionin. Tani ai ngul këmbë, që marrëdhënia ime e punës zgjatet për kohën e mungesës sime nga puna, pasi operacioni i gjurit tim i bie në afatin e dorëheqjes sime. A qëndron kjo?

Myriam Muff: Jo. Afati ligjor i heqjes dorë nga marrëdhënia e punës në rast sëmundjeje, aksidenti, shtatzënie apo shërbimi ushtarak (Art. 336c i së drejtës obligative) vlen vetëm atëherë, kur prishja e marrëveshjes së punës bëhet nga ana e punëdhënësit. Nëse si punëmarrës ju e bëni këtë dhe pastaj, fjala bie, shkak i sëmundjes apo aksidentit pa faj bëhet i paaftë për punë, afati i marrëdhënies së punës për këtë shkak nuk zgjatet. Në rastin tuaj marrëdhënia e punës përfundon brenda afatit ligjor të dorëheqjes.

Work, 18 maj 2018

Kompensimi i lehonisë: çka ndodh, nëse unë jap dorëheqje?

Unë jam shtatzënë në muajin e pestë. Termini provizor i lindjes është 30 shtatori 2018. Pas lindjes unë nuk dua që të punoj më tej. Kontrata ime e punës parasheh një afat prishjeje dymujore. Shefi më ka sugjeruar që të dorëzoi dorëheqjen në fund të korrikut për të përfunduar në fund të shtatorit. Një kolegë më tha që mos ta bëjë: Pasi kjo paraqet problem tek kompensimi i lehonisë. A ka ajo të drejtë?

David Aeby: Po. Kompensimi i lehonisë paguhet si para ditore dhe përbënë 80% të ardhurave para hyrjes në pushim të lehonisë, më së shumti 196 franga në ditë. E drejta e përfitimit fillon nga dita e lindjes dhe zgjat 14 javë. Për të pas të drejtë në kompensim të lehonisë, duhet të plotësohen disa parakushte. Posaçërisht duhet të ekziston marrëdhënia e punës në kohën e lindjes së fëmijës tuaj. Nëse marrëdhënia e punës ka përfunduar para se të lindni, do të humbni të drejtën në kompensim të parave të lehonisë. Pra, kurrësi mos u ngutni të prishni marrëdhënien tuaj të punës. Prisni me dorëheqje tek pas lindjes.

Work, 1. Juni 2018

Shtatzënë: A duhet të punoj natën?

Unë punoj në një bar dhe jam në muajin e pestë të shtatzënisë. Një kolege e punës më ka shpjeguar se, bazuar në ligj, gratë shtatzëna nuk guxojnë të punojnë fare pas orës 20. Lokali ynë hapet tek në mbrëmje dhe është hapur deri natën vonë. A mundem unë tani thjesht të qëndroj në shtëpi dhe megjithatë të marrë pagën?

David Aeby: Jo. Punëdhënësi duhet që grave shtatzëna, të cilat sikur ju punojnë mes orës 20 – 6, sipas mundësisë tu ofrojnë një punë të barasvlershme gjatë ditës nga ora 6 – 20. Tek vendi juaj i punës si duket diç e tillë nuk është e mundur, pasi lokali gjatë ditës është mbyllur. Ndoshta punëdhënësi juaj posedon edhe një ndërmarrje gastronomike, e cila është hapur gjatë ditës. Atëherë do të mund të punoni atje. Nëse shefi juaj nuk mund t'ju ofroj punë gjatë ditës dhe ju nuk mund të punoni natën, atëherë ju mund të rrinë në shtëpi dhe keni të drejtën e përfitimit të 80% të pagës suaj. Në 8 javët e fundit para lindjes shtatzënat nuk guxojnë në asnjë rast të punojnë natën mes orës 20 – 6, pra edhe atëherë jo kur ju me vetë dëshirë doni të punoni. Shefi juaj në raste të tilla është i obliguar, të ju ofroj juve punën ditën, ose të ju lirojë dhe t'ju paguaj 80% të pagës suaj.

Kosovë: Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë Disa arsye pse duhet ndryshuar dhe mbikëqyrur ky ligj

Në kuadër të kontrollit parlamentar, komisionet parlamentare që merren me monitorimin e këtij ligji duhet të rishikojnë periodikisht zbatimin e ligjit në mënyrë që të nxitet veprimtaria dhe të bëhet pastaj harmonizimi i legjislacionit për të promovuar sigurinë dhe masat mbrojtëse dhe parandaluese shëndetësore.

Sot, 19 vite pas çlirimit, 10 vite pas pavarësisë, e 5 vitet e fundit, sipas statistikave zyrtare në vendin e punës kanë vdekur 90 qytetarë të vendit. Secili prej tyre duhet të paraqesë një arsye më shumë për Kuvendin dhe Qeverinë që të ndryshohet Ligji për Siguri dhe Shëndet në punë, dhe të kërkohet zbatimi më i rreptë i këtij ligji.

Parimet e Kartës Sociale nga Këshilli i Evropës dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi mbesin veçse në letër, ndërsa puna e punëtorëve përveç që nuk shpërblehet me pagë të dinjitetshme për djersën e derdhur, ajo mund të bëhet edhe shkaktare për vdekjen, duke lënë edhe fëmijë pa mbrojtje e pa përkujdesje prindërore.

Mbrojtja e punëtorit para se të jetë politikë dhe mirëqenie sociale ajo duhet të jetë edhe politikë e praktikë kombëtare. Secili punëtor, që ka qenë i rrezikuar drejtpërdrejt për jetën e tij në vendin e punës, duhet të mbrohet nga një praktikë kombëtare. Veprimtaria e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në vendin e punës duhet të jetë me interes publik.

Të drejtat themelore janë të vendosura si bazë në Kartën Sociale të vitit 1989 nga Këshilli i Evropës dhe më pas edhe nga Bashkimi Evropian. Edhe pse karta nuk përmban dispozita detyruese për shtetet anëtare ose jo anëtare, megjithatë konsiderohet pozitive për sinjalin që e jep duke i'u referuar aspektit social. E disa pjesë të kësaj karte u bënë të detyrueshme në vitin 2009 me Traktatin e Lisbonës. Dinjiteti, liria, barazia, solidariteti, shtetësia dhe drejtësia janë pjesë e kësaj karte të cilat janë të drejta klasike njerëzore dhe civile.

Sa i përket Kosovës, duhet të shtrohet pyetja se çka kanë bërë qeveritë e deritanishme që siguria dhe shëndeti në punë të bëhen pjesë e përditshme e angazhimit publik? Mund ta matim me numrin e punëtorëve në Inspektorat të Punës, i cili në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale i numëron jo më shumë se 70 punëtorë me buxhet prej 621,907 euro, dukshëm më pak sesa numri i zëvendësministrave.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2013 e pati miratuar Ligjin për Siguri dhe Shëndetin në Punë. Ligji rregullonte aspekte të rëndësishme të ofrimit të mbrojtjes së punëtorëve por që plotësime thelbësore nuk u bënë në lexim të dytë për arsye se nuk kishte vullnet. Sot, këtij projektligji i mungon një dispozitë ku punëtorëve në mungesë të mjeteve, duhet t'u sigurohet asistencë juridike falas, apo me kushte shumë të volitshme.

Siguria në punë dhe rregullat e mbrojtjes shëndetësore të lidhura me masat parandaluese duhet të zbatohen pa asnjë kosto financiare për punëtorët. Sot, shërbimet e avokatisë janë shumë të larta e punëtorët e thjeshtë nuk mund të sigurojnë mbështetje juridike nëse dëshirojnë t'i provojnë shkeljet e mundshme. E këtu, më duhet të përmend që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në kuadër të buxhetit të saj operon me 26 punëtorë administrativë me buxhet rreth 350 mijë euro, i cili nuk është aspak i mjaftueshëm.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore duhet të përfshihet edhe një nen ku për punëtorët me një kapacitet të reduktuar për punë janë ata punëtorë të cilëve kapaciteti për punë iu është zvogëluar si rezultat i moshës, te sëmundjet profesionale ose të tjera sëmundje, dhe faktorë të tjerë që do të përcaktohenin me ndonjë marrëveshje të veçantë kolektive ose një rregull të përgjithshëm të punëdhënësit.

Po ashtu në kuadër të ndryshimeve ligjore duhet të përfshihet edhe mbrojtja e grave në punë e cila duhet të kryhet në përputhje me Ligjin e Punës. Gjatë shtatzënisë një grua nuk duhet të caktohet për punën e një zjarrfikëseje, për të punuar në lartësi, nëse ka një mikroklime të papërshtatshme, zhurmë dhe dridhje, presion atmosferik të lartë, ekspozim ndaj rrezatimit etj. Në lidhje me këtë të fundit shumë gra police në Kosovë punojnë në reception të institucioneve të larta publike afër rrezeve X të skanerëve.

Konsideroj që ndryshimet ligjore duhet të shkojnë deri te ndërhyrja në kurikulat e shkollave fillore ku do të përfshihen rregullat themelore të sigurisë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit. Ndërsa në shkolla të mesme të përfshihen programet e trajnimit për aftësi të reja, për punë të veçanta. Kurse kualifikimet më të larta të mbulojnë edhe rregullat e veçanta të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë në një fushë të përshtatshme për aftësi të reja, punë të veçantë dhe kualifikim të lartë për të cilat kryhet trajnimi. E në këtë kuptim, kjo do të kryhej në bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ndërsa në kuadër të kontrollit parlamentar, komisionet parlamentare që merren me monitorimin e këtij ligji duhet të rishikojnë periodikisht zbatimin e ligjit në mënyrë që të nxitet veprimtaria dhe të bëhet pastaj harmonizimi i legjislacionit për të promovuar sigurinë dhe masat mbrojtëse dhe parandaluese shëndetësore.

Naim Jakaj, Këshilltar i Nënkretares së Kuvendit

Kurse gjuhësore për ndërtimtarinë kryesore Kurs i gjermanishtes për punëtorë të ndërtimtarisë

Edhe kësaj vjeshte me mandat të partnerëve social të ndërtimtarisë kryesore përsëri do të ofrohen kurse të gjermanishtes për punëtorë të ndërtimtarisë. Kurset realizohen nga Instituti për arsimim të të rriturve ECAP sipas konceptit-fide dhe janë të përpiluara në veçanti për nevojat e migrantëve, të cilët punojnë në ndërtimtarinë kryesore.

Do të trajtohen tema të përzgjedhura nga tematika e ndërtimtarisë si dhe nga përditshmëria private e pjesëmarrësve. Fondacioni ECAP në bashkëpunim të ngushtë me fondin e paritetit të ndërtimit ka përgatitur materialin mësimor për 5 skenarë specifik të ndërtimtarisë (Udhëzimi, problemet në kantier, biseda të shkurta, biseda bashkëpunëtorësh, informimi mbi sëmundjen, aksidentin apo vonesën). Synimi kryesor është vu tek ngritja e aftësisë së komunikimit gojor.

Grupi i synuar Punëtorët me gjuhë të huaj që punojnë në ndërtimtarinë kryesore.
Kohëzgjatja shtator – dhjetor 2018
Vendi i kurseve Aarau, Bazel, Bernë, Biel

Kohëzgjatja e kursit 13 javë (gjithsejtë 52 mësimet nga 45 minuta)
Ditët e kursit të shtunave
Kostoja Fr. 100.00 përfshirë edhe materiali i kursit
Kompensimi Pjesëmarrësit të cilët e përfundojnë me sukses kursin, do të marrin një kompensim, nëse janë kualifikuar për këtë.
Madhësia e grupit 10 – 14 pjesëmarrës/e. Kurset do të mund të zhvillohen, vetëm nëse gjenden së paku 10 veta për kurs

I interesuar? Për më shumë informata, të lutemi drejtohu në sekretariatit e Unia-s në afërsinë Tënde, apo përmes e-mailit sprachkurse@unia.ch